



84

146

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E DREJTËSISË**  
**AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

"Bulevardi Dëshmorët e Kombit", Kulla Binjake nr.2, Tiranë Tel / Fax ++355 4 256 831

Nr. 204/5 Prot.

Datë, 24 109 / 2008



**V E N D I M**

Nr. 1069, datë 24 109 / 2008

**PËR**  
**NJOHJEN E SË DREJTËS SË PRONËSISË, KTHIMIN DHE/OSE**  
**KOMPENSIMIN E PRONËS**

Sot më datë 24/09/2008 në mbështetje të të nenit 16; pika 1, të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, dhe të Vendimit nr. 566, datë 23.08.2006 të Këshillit të Ministrave, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, mora në shqyrtim kërkesën ankimore nr. 204 prot, datë 25.03.2008, që i përket subjektit të shpronësuar,

**Ankues:** — Z. Mikel Pepa, përfaqësues sipas prokurave nr. 262 rep., nr. 158 kol, datë 08.02.1997, të Dhomës së Noterëve Durrës, dhe nr. 4290 rep., datë 01.11.1995, i Noteres Irena Bimo Vlorë, i trashëgimtarëve të subjekteve të shpronësuara Jorgji Veveçka, Sofia Koleas, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi.

**Me objekt :** Kundërshtim i Vendimit nr.380, datë 28.12.2007, të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Qarku Durrës.


**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar

Pasi shqyrtova ankesën e z. Mikel Pepa, dokumentacionin bashkëlidhur saj, materialet shkresore të ndodhura në dosjen nr.58 prot., datë 05.04.2007, të hapur pranë Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave qarku Durrës, si dhe dokumentacionin e administruar në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, në zbatim të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" të ndryshuar,

**VËREJ SE :**

Z. Mikel Pepa, përfaqësues sipas prokurave nr. 262 rep., nr. 158 kol, datë 08.02.1997, të Dhomës së Noterëve Durrës, dhe nr. 4290 rep., datë 01.11.1995, i Noteres Irena Bimo

484



trashëgimtarëve të subjekteve të shpronësuara Jorgji Vevecka, Sofia Koleas, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi, ka paraqitur ankimin kundër vendimit nr.380, datë 28.12.2007, të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Rrethit Qarku Durrës. Ky ankim është administruar nga ZRKKP qarku Durrës me nr. 58/35 prot., datë 01.01.2008, kjo konform VKM nr 747, datë 9.11.2006, seksioni I, pika 4. ZRKKP qarku Durrës me shkresën nr. 1636, datë 11.02.2008, ka përcjellë pranë AKKP-së ankimin e paraqitur dhe dosjen mbi bazën e së cilës është dhënë vendimi objekt ankimi, protokolluar nga AKKP me nr. 591 prot., datë 11.03.2008.

Nisur nga sa më sipër, bazuar në kërkesat e akteve ligjore e nënligjore në fuqi, në pikëpamje të së drejtës procedurale, paraprakisht vlerësoj se:

**Së pari**, shqyrtimi i këtij ankimi është në kompetencat ligjore të AKKP-së në bazë të nenit 16 pika 1, gërma c të Ligjit nr.9235,29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” të ndryshuar sipas të cilit:

“Zyra e AKKP-së në qendër shqyrtton ankimin ndaj vendimeve të zyrës rajonale të AKKP-së në qark apo ish-komisionit vendor për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

**Së dyti**, ankimesi në cilësinë e përfaqësuesit të trashëgimtarëve ligjorë të subjekteve Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, egjitimohet të kundërshtojë vendimin nr.380, datë 28.12.2007, të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Durrës në AKKP, pasi vendimi i sipërcituar ka trajtuar kërkesën e tij dhe të përfaqësuarve prej tij dhe në këtë mënyrë prej këtij vendimi pretendohet se preken të drejta legjitime të tyre.

**Së treti**, vendimi është ankimuar brenda afatit të përcaktuar në nenin 18, pika 1 të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar. Për vendimin nr. 384, datë 04.01.2008, ankimesi ankimesi ka marrë dijeni me shkresën nr. 58/33, datë 17.01.2008, të ZRKKP qarku Durrës dhe ka ushtruar të drejtën e tij të ankimit më datë 01.02.2008, sikundër rezulton nga data e plotësuar në formularin tip dhe mandat arkëtimin, pra brenda afatit 30 ditore të përcaktuar në ligj.


**Nga shqyrtimi i dosjes dhe i dokumentave të administruara për vendimin objekt ankimi rezulton që :**

Trashëgimtarët e subjekteve Jorgji Vevecka; Sofia Kolea; Kostandin Mima; Evdhoqes Goxhomani; Ariadhni Konomi sipas dëshmime të trashëgmive lëshuar nga Noteria Tiranë nr.704 datë 16.07.1993, vendimet e gjykatës Tiranë nr. 2049 datë 31.05.2002 e Nr. 5220 datë 03.07.2007, vendimi i gjykatës Berat nr. 975 datë 11.10.2005, dhe vendimet e gjykatës Vlorë nr 1134 datë 23.06.2006 e nr. 1105 datë 17.06.2005, i janë drejtuar ZRKKP qarku Durrës më datë 25.06.2007, me kërkesën me objekt njohjen/kthimin/kompensimin e pronës me sipërfaqe 1 820 000 m2, pjesë e pronës së quajtur « Çifligu Rushkull i Ri » me sipërfaqe të përgjithshme prej 2943 ha, çiflig i cili ka këto kufizime Veriu- Qorrallinjte, Fuat bej dhe Zija bej Toptani, Jugu- shoqëria “EIA” dhe lumi Erzen, Lindje- Qani Hanëm dhe Fuat bej Toptani, Perëndimi- det i.

ZRKKP qarku Durrës, gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë të paraqitur nga familjet Vevecka, hallvari, Kolea, Mima, Goxhomani, Konomi, dhe atij të siguruar nga institucionet e

485

178



ZVRPP Durrës shkresa nr.1316/1, datë 30.06.2007, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, shkresa nr. 247/1, datë 12.07.1007, në zbatim edhe të detyrave të lëna nga AKKP me vendimin nr. 258, datë 18.09.2007, ka vlerësuar se për trajtimin e kësaj kërkesë duhen analizuar dy probleme kryesore, konkretisht:

a.) A plotëson të gjitha kërkesat e ligjit 9235 datë 29.07.2004 i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dokumentacioni i pronës së pretenduar?

Sa i përket këtij problemi, ZRKKP qarku Durrës, pas analizës së dokumentacionit bashkëlidhur saj si dhe atij të krijuar gjatë shqyrtimit të kërkesës, për këtë problem ka arritur në konkluzionin se **dokumentacioni është i plotë dhe konform kërkesave të ligjit 9235 datë 29.07.2004 i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.**

b.) A legjitimohen si palë në këtë proces administrativ trashgimtarët e subjekteve pretendues duke përjashtuar subjektin Maria (Lubica) Shallvari Lampo?

ZRKKP qarku Durrës, pas analizës së dokumentacionit bashkëlidhur kërkesës së paraqitur me nr. 58/6 prot., datë 25.06.2007, si dhe atij të krijuar gjatë procedimit për shqyrtimin e saj, për këtë problem ka arritur në konkluzionin se **kërkuesit bazuar në nenin 45 të ligjit Nr 84 85 datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative" të R.Sh. nuk legjitimohen si palë në procesin administrativ.**

Mbi bazën e konkluzioneve sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit administrativ, ZRKKP qarku Durrës ka vlerësuar se nuk duhet të njihet e drejta e pronësisë trashgimtarëve kërkues të subjekteve pretendues si të shpronësuara për pronën e pretenduar me sipërfaqe 1 820 000 m<sup>2</sup>, pjesë e sipërfaqes e pronës së quajtur "Çifliku Rrushkull e Çifliku i Ri" me sipërfaqe prej 2943 ha, si kërkesë në kundërshtim me ligjin Nr.9235 datë 29.07.2004 i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe rendit juridik ne fuqi, **duke e trajtuar kërkesën me vendimin nr. 380, datë 28.12.2007, me anë të së cilit ka vendosur:**

a) Të mos njohë të drejtën e pronësisë trashëgimtarëve të subjekteve pretendues si të shpronësuara Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi, që dalin nga dëshmitë e trashëgimive të dhëna në pikën 3 të këtij vendimi, për pronën me sipërfaqe 1 820 000 m<sup>2</sup>, e ndodhur ndodhur në fshatin Hamallaj (sektor), të rrethit të Durrësit në ZK 1925, me indeks harte K-34-88-(144-B, 146-A, 129-D, 161-B) me këto kufij: Veriu: pas nr. 49, 54/2, 133/2 e kanali I hidrovorit; Jug- vija ndarëse midis fshatit Rrushkull-Hamallaj (sektor); Perëndim – pasuria nr. 21/8, 21/6, Lindje – pas. Nr. 133/2, 49, 139, 146, 87, për faktin se këta trashëgimtarë **nuk legjitimohen si palë në procesin administrativ për mangësitë e dala në pjesën përshkruese të vlerësimit ligjor që ndodhet në dosje.**

Z. Mikel Pepa, përfaqësuesi i trashëgimtarëve të subjekteve Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi, në kërkesën e tij ankimore, parashtron se vendimi nr. 383, datë 04.01.2008, i ZRKKP qarku Durrës është i gabuar dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004, dhe aktet nënligjore dalë për zbatim të tij, duke pretenduar se:

1786

18

Dokumentat e origjinës së pronës, pra titulli i pronësisë është i saktë, fakt i cili pranohet edhe ZRKKP qarku Durrës;

Pretendimi se trashëgimtarët e z.Jorgji Vevecka, zj. Sofia Kolea, z. Kostandin Mima, zj. Evdhoqes Goxhomani, zj. Ariadhni Konomi, nuk legjitimohen si palë në procedimin administrativ, është i padrejtë, pasi vendimi nr. 52, datë 02.03.1946, të Gjykatës Durrës, i cili ka marrë formë të prerë dhe nuk është ndryshuar ose shpallur i pavlefshëm nga asnjë akt tjetër juridik, dhe në këto kushte është akt plotësisht i vlefshëm, duke na legjitimuar plotësisht si palë në rocesin administrativ.

Sa më sipër, ankimuesi shprehet se këto pretendime mbështeten në dokumentat ligjorë të pakundërshtuar të administruara në dosjen nr. 58, datë 05.04.2007, dhe kërkon nga AKKP shfuqizimin e vendimit nr. 380, datë 28.12.2007, të ZRKKP qarku Durrës, dhe zgjidhjen në themel të çështjes duke njohur/kthyer/kompensuar pronën me sipërfaqe 1 820 000 m2 ( në total 2943 ha, diferenca e trajtuar me vendimet nr. 379, datë 28.12.2007, nr. 383 dhe nr. 384, datë 04.01.2008, të ZTKKP qarku Durrës).

**Pasi u shqyrtua kërkesa ankimore dhe dokumentacioni bashkëlidhur saj, si dhe dokumentacioni i administruar gjatë këtij procedimi administrativ, po ashtu dokumentacioni i administruar në dosjen bazë nr. 58, datë 05.04.2007, konstatoj dhe ligjërisht vlerësoj se:**

Objekt procedimi në këtë rast është vlerësimi i rrethanave dhe fakteve me qëllim që krijimi i pasojave juridike në përfundim të këtij procedimi, dhe përmbajtja e aktit të jenë në përputhje me qëllimin dhe përmbajtjen e ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004, të ndryshuar. Në këtë kontekst, konstatoj dhe ligjërisht vlerësoj se:

1. Dokumentacioni ligjor i paraqitur, me të cilin kërkuesit/ankuesit pretendojnë të provojnë për pretendimin e tyre për pronësinë:
  - Vërtetim nga dokumenti hipotekor, lëshuar nga ZRPP Durrës më datë 09.11.2005, me anë të së cilit vërtetohet se në rregjistrin hipotekor me nr. 465 rregjistri, datë 20.02.1940, figuron e rregjistruar në pronësi të Jorgji Vevecka, Sofia (Vevecka) Kolea, Kostandin Mima çifligu Rrushkull më kufij: Perëndim – det, Veri Qorralinjte, Fuat bej dhe Zija bej Toptani, Lindje – Qani Hanëm dhe Fuat Bej Toptani, Jug – shoqëria E.I.A.A., lumi Erzen;
  - Fletë nga radhori për traskiptimet i Ipotekës traskiptim kërkesë-padie, me nr. 465 rregjistri;
  - Vërtetim pronësie lëshuar nga Ipoteka Durrës datë 12.03.1993;
  - Vërtetim pronësie lëshuar nga Ipoteka Durrës datë 19.01.1994;
  - Vendim i Gjykatës Durrës Nr. 52 datë 02.03.1946;
  - Vendim i Gjykatës Durrës nr.1 datë 03.01.1997 “përcaktim siperfaqe”;

Nga analiza e dokumentave si më sipër listuar, vlerësoj se dokumentacioni i paraqitur nga ana formale është në respektim të V.K.M. nr 747, date 09.11.2006, seksioni I, pika 3/a, germa i e vi, por me anë të tij nuk vërtetohet pronësia e pretenduar prej subjekteve pretendues si ish-pronarë, pasi:

Vërtetimi hipotekor, lëshuar nga ZVRPP Durrës më datë 09.11.2005, i cili i referohet rregjistrin hipotekor me nr. 465, datë 20.02.1940, rezulton të jetë transkriptim i një kërkesë padie të bërë në Gjykatën Kolegjiale nga Jorgji Vevecka etj., kundra Nikolla

160

IRANE 31/11/2007  
KETA

Shallvarit, Lubica Maria Amalia Lampo etj., për njohje trashëgimie dhe pjesitim të çiflikut Rrushkull me kufij: perëndimi Deti, Veriu Qorrallinjte, Fuat Bej dhe Zija Bej Toptani, Jugu: shoqëria E.I.A.A. lumi Erzen.

Sa më sipër, ky dokument nuk vërtetohet aspak që subjektet të kenë gëzuar titullin e pronësisë për pronën "çifliku Rrushkull", pjesë të së cilit është kërkimi në shqyrtim, dhe për më tepër nuk vërtetohet origjinë pronësie për subjektet kërkuese.

Po kështu, edhe vërtetimet e hipotekës të datës 12.03.1993 dhe 19.01.1994, i referohen rregjistrimit hipotekor nr. 465, datë 20.02.1940, që sikundër u analizua rezultoi të jetë transkriptim i kërkesë padisë të bërë në Gjykatën Kolegjiale nga Jorgji Veveçka etj., kundra Nikolla Shallvarit, Lubica Maria Amalia Lampo etj., për njohje trashëgimie dhe pjesitim të çiflikut Rrushkull me kufij: perëndimi Deti, Veriu Qorrallinjte, Fuat Bej dhe Zija Bej Toptani, Jugu: shoqëria E.I.A.A. lumi Erzen.

IRANE 31/11/2007  
KETA

Vendimi i Gjykatës Durrës, nr. 1, datë 03.01.1997, me anë të të cilit subjektet kanë përcaktuar sipërfaqen e pronës, është bazuar në rregjistrin hipotekor nr. 465, datë 20.02.1940, pra si bazë për këtë vendim ka shërbyer një kërkesë padi e transkriptuar në rregjistrat e hipotekës, e cila është vlerësuar si vërtetim pronësie.

Përfundimisht, dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesit formalisht plotëson kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore, por nuk është ligjërish i mjaftueshëm në funksion të objektit të kërkesës.

Përveç dokumentacionit si më sipër të paraqitur nga kërkuesit, ZRKKP qarku Durrës, ka administruar 19 fletë të transkriptimit të pronës së nga ZVRPP Durrës me shkresën Nr. 1805/1 prot date 30.08.2007.

Nga analiza e këtij dokumentacioni, sa i përket origjinës së pronës rezultoi se:

- E gjithë prona ka qene ne emër të Z.Miltiadh Shallvari dhe e ka origjinën në librin 10 të kadastrës faqe nr 21, 22, 23, 24 date 19.08.1919 dhe me numrat prej 31 deri në 56;
- Z. Miltiadh Shallvari, e ka disponuar të gjithë pronën me testamentin e datës 08.05.1929 dhe pas vdekjes së testatorit në datë 17.05.1933, prona është transkriptuar në vitin 1940, në volumnin 11 rep, me nr. Rendor. 527 faqe 32 vol 12 dosje artikull 117, në favor të Znj.Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo; në kolonën shënime të kësaj note ka transkriptim me nr. 628, 528, datë 27.04.1940, ku në numrin rendor vjetror 528 rezultoi transkriptimi në favor të zj. Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo kundra zj. Edita Shallvari e bija e Miltiadh Shallvarit dhe z. Nikolo Shallvari vëllai i Miltiadh Shallvarit, ku këta të fundit deklarojnë se renoncojnë në favor të zj. Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo nga çdo lloj e drejte që atyre i takon ose mundet tu takonte mbi pronat e quajtura Rrushkull e Çiflik i Ri, për shkak të trashëgimisë nga i ndjeri Miltiadh Shallvari, respektivisht i ati dhe i vëllai i renoncoesve, ose për çdo titull tjetër brenda kufijve të pronës së Miltiadh Shallvarit lëshuar nga kadastra e Durrësit me numrat që fillojnë nga 31 deri 56, ku përfshihet prona e quajtur Rrushkull, në të cilën është pjesë e pandarë Çifiku i Ri për të cilin paguhen taksat nën emrin Rrushkull;
- Po në kollonën shënime ka transkript në numrin 629/529, datë 27 prill 1940 xviii, në favor të shoqërisë anonime Ente Industria Attivita Agrarie shkurtimisht E.I.A.A, kundra znj. Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo, e veja e Miltiadh Shallvarit, e cila i koncedon me enfiteoz per 99 vjet në favor të kësaj shoqërie pronat e quajtura Rrushkull e Çiflik i Ri, me kufij të përcaktuar, me të gjitha aksesorët dhe ndërtesat brenda;

5  
488

181

Transkripti tjetër nr. 126, datë 29.05.1946 prona është traskiptuar në favor të shtetit shqiptar kundra shoqërisë anonime Ente Industria Attivita Agrarie shkurtimisht E.I.A.A. Në këtë traskiptim kemi sekuestrimin e kësaj prone shoqërisë E.I.A.A. nga ana e shtetit, në bazë të dispozitave të ligjit nr. 36, datë 14.01.1945 "Mbi konfiskimin e pasurive të shtetasve italianë dhe gjermanë të ndodhura në Shqipëri", dhe saktësohet se prona është marrë me pajtim nga Znj. Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo, e cila i ka hipotekuar pronat e Rrushkullit dhe Çiflikut të Ri në favor të shoqërisë E.I.A.A. për një shumë 500 000 franga ari.

Nga analiza e gjithë dokumentacionit si më sipër, ankuesit nuk rezultojnë të kenë gëzuar titullin e pronësisë, të vetëm ose në bashkëpronësi, për pronën e pretenduar. Në përfundim e gjithë prona rezulton në emër të zj. Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo, dhënë me emfiteozë për 99 vjet shoqërisë E.I.A.A., dhe sekuestruar nga shteti shqiptar kësaj shoqërie.

Referuar rregjistrin nr. 465, datë 20.02.1940, rezulton transkriptimi i kërkesë padisë së Jorgji Vevecka, Sofia Kola, Kostandin Mima kundra Nikolla Shallvarit etj. depozituar në Gjykatën Kolegjiale për njohje trashëgimie dhe pjestim të çiflikut Rrushkulli, me kufinj të përcaktuar.

Gjyqi Civil i Prefekturës së Durrësit me vendimin nr. 52, datë 2.03.1946, ka vendosur deklarin si bashkëzotëuese të Maria Lubica Shallvari, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi, të çiflikut Rrushkull, duke përcaktuar pjesët takuese respektive në pasuritë mylk dhe tokë.

Referuar analizës së pjesës arsyetuese të vendimit të gjykatës, ku shprehet se "Me qënë se prona që kërkohet pjestimi goditet prej nenit 1, 3 dhe 7, të Ligjit "Për Reformën Agrare" dhe kështu nuk është i mundur pjestimi në natyrë dhe për të drejtat që eventualisht mund t'u njihen ndërgjygsave prej ligjit në fjalë mund t'i kërkojnë në bazë të nenit 35 të po kësaj ligje pasi të caktohen pjesët prej këtij kolegji."

Sa më sipër, rezulton se në kohën e dhënies së këtij vendimi, kishte hyrë në fuqi Ligji nr. 108, datë 29.08.1945 "Për Reformën Agrare", ku në kapitullin e parë të tij përcaktoheshin tokat që goditen nga shpronësimi si dhe përjashtimet. Ashtu sikundër analizon edhe gjykata, prona goditej prej nenit 1, 3 dhe 7, të Ligjit nr. 108 "Për Reformën Agrare".

Referuar këtyre dispozitave rezulton se:

- Neni 1, pika 3, të tij përcaktonte se "Me shpalljen e kësaj ligje shpronësohen detyrimisht dhe u ndahen fshatarëve nënshitetas shqiptarë që s'kanë tokë të tyre ose që nuk u mjafton toka:....3) pronat bujqësore private dhe të enteve private dhe fetare me përjashtimet e përshkruara në nenin 2 të kësaj ligje..";

- Ndërkohë që neni 7 përcaktonte se "Gjer në një urdhëresë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve gjithë pronat private që mbeten të paçpronësuara në bazë të dispozitave të kësaj ligje, nuk mund të jetërosen me çdo titull ose të ipotekohen ose të jepen me qera, veçmas me vendim të Komitetit Ekzekutiv të Nënprefekturës, pasi të jetë marrë mendimi i Zyrës së Reformës Agrare".

Ndërsa neni 35 të po këtij ligji, Gjykata i referohet duke u shprehur se të drejtat që eventualisht mund t'i njihen ndërgjygsave mund të kërkojnë në bazë të kësaj dispozite, ku përcaktohej se. "Konfliktet që lindin nga aplikimi i kësaj ligje midis pronarëve,

182

fshatarëve të shtetit, zgjidhen paqësisht nga Zyra e Reformës Agrare në bashkëpunim me Komitetin e Fshatarëve. Në qoftë se nuk është e mundur zgjidhja paqësore, konfliktet zgjidhen në shkallë të parë prej një Komisioni të kryesuar prej Kryetarit të Gjykatës Popullore të Rrethit, ose prej gjyqtarit popullor të caktuar nga Ministrija e Drejtësisë dhe të p[ë]rbërë prej Kryetarit të Zyrës së Reformës Agrare ose zëvendësit të tij.....Vendimet e këtij komisioni apeloohen brenda 20 ditëve nga data e njoftimit të vendimit që bëhet kryesisht. ....

Prona është transkriptuar në favor të shtetit shqiptar kundra shoqërisë anonime E.I.A.A. më datë 29.05.1946, pra dy muaj më vonë nga shpallja e vendimit të gjyqit Civil të Prefekturës së Durrësit, vendim në të cilin nuk ka asnjë shënim që të vërtetojë se ka marrë formë të prerë, ashtu sikundër pretendohet nga ankimuesit.

Së dyti, referuar dispozitave të Ligjit nr. 108 "Për Reformën Agrare", cituar më lart, të cilave i është referuar edhe Gjyqi Civil I prefekturës së Durrësit, arrihet në përfundimin se transkripti në rregjistrat e hipotekës mbi bazën e vendimit të këtij Gjyqi nr. 52, datë 12.03.1946, nuk mund të kryhej pasi kjo pronë shpronësohej detyrimisht sipas urdhërimeve të nenit 1 dhe 2 të Ligjit nr. 108 "Për Reformën Agrare".

Në këto kushte, edhe duke vlerësuar se vendimi i Gjyqi Civil të Prefekturës së Durrësit mund të jetë i formës së prerë, mospaqyrimi i këtij vendimi në rregjistrat e hipotekës nuk i legjitimon ankimuesit në pretendimin e tyre si ish-pronarë, kjo në pikpamje juridike, materiale dhe procedurale. Kalimi i të drejtave reale, titullit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme përfundon kur akti ligjor me të cilin është fituar titulli i pronësisë rregjistrohet pranë zyrës së hipotekave.

Bashkëzotërimi i pronës, objekt material i këtij shqyrtimi administrativ, nga J.Vevecka, S.Kolea, K.Mima, E.Goxhomani, A.Konomi dhe Maria Lubica Shallvari, është vendosur me vendim gjyqësor, por ky vendim nuk është transkriptuar në rregjistrat e hipotekës së kohës dhe për pasojë nuk ka prodhuar efektet e tij juridike, pra kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pronën e pretenduar nga Sllava Maria Amalia Lampo te subjektet Vevecka, Mima, Kolea, Goxhumani, Konomi.

Në kuptim të nenit 1 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004, të ndryshuar, ku përcaktohet se "Ky ligj ka për objekt: a) rregullimin e drejtë, sipas kriterëve të nenit 41 të Kushtetutës të çështjeve të së drejtës së pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet apo konfiskimet....", dhe më tej të nenit 2 "E drejta e pronësisë" ku përcaktohet se "Çdo subjekt i shpronësuar ka të drejtë të kërkojë në përputhje me këtë ligj, të drejtën e pronësisë, në rast se II është hequr sipas akteve ligjore, nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti nga data 29.11.1944, si dhe kthimin dhe kompensimin e pronës", ankimuesit nuk mund të kërkojnë të drejtën e pronësisë në përputhje me këtë ligj, pasi ata nuk vërtetojnë ashtu sikundër kërkohet nga urdhërimet e akteve ligjore e nënligjore titullin e pronësisë, dhe për më tepër shpronësimin e padrejtë nga shteti për tu cilësuar "subjekte të shpronësuar" në kuptim të këtij ligji.

Në përfundim, vlerësoj se dokumentacioni i paraqitur është i ligjshëm pasi është siguruar nga institucione shtetërore, në respektim të V.K.M. nr 747, datë 09.11.2006, seksioni I, pika 3/a, germa i e vi, por në kush tet kur me me anë të tij nuk vërtetohet pronësia e subjekteve pretendues si ish-pronarë të shpronësuar

183  
padrejtësisht dokumentacion nuk është ligjërish i mjaftueshëm për kërkimin në shqyrtim.

Gjithashtu, bazuar edhe në nenin 45 të ligjit Nr 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative" të R.Sh., ankimesit nuk legjitimohen si palë në procesin administrativ, pasi dispozita sipërcituar përcakton se "*Mbajtësit e të drejtave dhe interesave të ligjshme, të cilat preken nga vendimet që merren gjatë procedimit administrativ, kanë të drejtë të fillojnë procedimin administrativ si dhe të marrin pjesë në të*", pasi nuk provojnë ashtu sikundër kërkohet ligjërish se janë mbajtës të të drejtave të ligjshme.

Sa i përket dokumentacionit hartografik, subjekti ka paraqitur pozicionimin e pronës së pretenduar në hartë kadastrale shk 1:10 000, i cili është administruar në nga gjykata në dhënien e vendimit nr. 1, datë 03.01.1997, miratuar nga Seksioni i Kadastrës. Gjithashtu, është paraqitur pozicioni gjeografik i të gjithë pronës në plansheta të konfirmuara nga ZVRPP të shk 1:2500.

Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion hartografik për gjendjen e mëparshme të pronës së pretenduar, duke mos përmbushur kështu kriteret e VKM 747, datë 9.11.2006, seksioni I, pika 3/b.

Sa më sipër, ligjërish vlerësoj se vendimi nr. 380, datë 28.12.2007, i ZRKKP qarku Durrës, është i drejtë, i mbështetur në ligj e në prova dhe si i tillë duhet lënë në fuqi.

Ndërsa pretendimet e ankuesit nuk mund të pranohen, pasi rezultojnë të pa mbështetura në prova e ligj. Sikundër u analizua, me dokumentacionin e paraqitur subjektet Jorgji Veyecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi, nuk arrijnë të provojnë se e kanë gëzuar titullin e pronësisë mbi pronën objekt kërkimi dhe për më tepër të provojë shpronësimin, konfiskimin apo marrjen në mënyrë të padrejtë nga shteti për tu cilësuar "subjekt i shpronësuar" në kuptim të nenit 3/3 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004.

Në këto kushte, në mbështetje të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", pas shqyrtimit të gjithë rrethanave të mësipërme, dhe vlerësimit ligjor të paraqitur, çmoj se arsyetimi i bërë nga ZRKKP qarku Durrës, është i drejtë, i bazuar në ligj e në prova.

Ndërsa pretendimet e ankuesit vlerësohen jo të drejta, të pabazuara në ligj e prova, prandaj nuk mund të pranohen.

### PËR KËTO ARËSYE,

Bazuar në sa më sipër dhe në mbështetje të nenit 16 pika 1, gërma "c", nenit 18, pika 1 gërma "a", të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së,

### V E N D O S A :

Lënie në fuqi të vendimit nr.380, datë 28.12.2007, të ZRKKP qarku Durrës.



184

SEKRETI  
TIRANE  
SEKRETARIA

Ky vendim hartohet në pesë kopje, nga të cilat dy kopje në protokollin e institucionit, një kopje i njoftohet ankuesit, një kopje Zyrës Rajone të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Durrës dhe një kopje i dërgohet Avokaturës së Shtetit.


3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot më datë 24/09/2008.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave



Shënim: Ky vendim përbën titull ekzekutiv nga data 24/09/08  
Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, [Signature]  
(emër, mbiemër, firmë) (ë)



Ndërsa pretendimet e ankuesit...

...

...

u82